

VENDIM
Nr. 407, datë 18.6.2014

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 840, DATË 17.12.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË
SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 840, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Pas shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) Mirëmbajtja e godinës, ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe përmirësimi i inventarit material të kësaj ministrie.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Për të krijuar, garantuar dhe përmirësuar kushtet e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Trupit Diplomantik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera apo pranë organizatave ndërkombëtare, DSHTD-ja përdor burimet e veta financiare. Gjithashtu, DSHTD-ja përballon me fondet e saj, tërësisht apo pjesërisht, shpenzimet për ndërtimin apo blerjen e objekteve të reja, pronë e shtetit shqiptar, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama